



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 23.06.2020)*

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:00 dhe mbaroi në orën 13:05.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Maksim Qoku* (zëvendëskryetar)
3. *Medi Bici* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
11. *Marçela Shehu* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Hapet mbledhja plenare me fjalën e Kryetares së Këshillit e cila shprehet se ditën e djeshme është paraqitur një kërkesë nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për caktimin e një gjyqtari për gjykimin e një çështjeje në këtë gjykatë dhe për shkak të urgjencës që ka kërkesa thërritet kjo mbledhje e sotme me këtë objekt shqyrtimi. Për më shumë detaje, i jepet fjala zotit Ilir Toska lidhur me relatimin e çështjes.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar** ka paraqitur ditën e djeshme një kërkesë me anë të së cilës kërkohet caktimi i një gjyqtari, kërkesë e karakterit tepër urgjent për përjashtim të trupit gjykues.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore, të jenë gjykatat me juridiksion të përgjithshëm dhe numri i gjyqtarëve të jetë 1. Gjyqtari duhet të përzgjidhet, me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti, propozohet që të përjashtohen nga shorti

gjqtarët që janë caktuar më herët sipas kësaj skeme në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht: znj. Alma Kolgjoka, znj.Ornela Naqellari; z. Rexhep Bekteshi; znj. Esmeralda Xhili (Çeka), z Enton Dhimitri. Po kështu ka edhe një propozim që të përjashtohet nga shorti dhe një nga gjyqtarët që bën pjesë në listën e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret, z. Artur Kalaja i cili është në përbërje të trupit gjykues që po gjykon bashkë me gjyqtaren e cila është në kallëzuar penalisht çështjen penale të themelit.

Gjyqtarët që plotësojnë kriteret janë: Enton Dhimitri; Margarita Buhali; Artur Kalaja; Astrit Kalaja; Dritan Banushi; Miranda Andoni; Manjola Xhaxho; Alma Kolgjoka; Ornela Naqellari; Esmeralda Xhili (Çeka); Rexhep Bekteshi; Edlira Petri.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime mbi propozimet e Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik, i cili mundësohet nga specialiste znj. Valbona Bako.

Nga shorti elektronik përzgjidhet gjyqtarja Margarita Buhali, e cila caktohet për të gjykuar çështjen e veçantë në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

\* \* \*

(Mbledhja konsiderohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**